



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.145

31 tetor

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 466 datë 6.10.2011	Për një ndryshim në ligjin nr.8386, datë 30.7.1998 “Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pronave të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar 6539
Ligj nr.10 468 datë 6.10.2011	Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit për vitin 2010 6539
Vendim i KM nr.664, datë 28.9.2011	Për motivimin, rregullat dhe procedurat për dhënien e medaljeve, formën e tyre dhe shpërblimin financiar 6541
Vendim i KM nr.673, datë 6.10.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për riparimin e mbulesës së sallës së madhe të koncerteve, në Pallatin e Kongreseve 6542
Vendim i KM nr.713, datë 20.10.2011	Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme 6543
Urdhër i MD nr.2004, datë 15.3.2011	Për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit..... 6545
Urdhër i MD nr.5123/3, datë 24.8.2011	Për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit 6545
Urdhër i MD nr.5123/3, datë 24.8.2011	Për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit 6546
Urdhër i MD nr.5123/3, datë 24.8.2011	Për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit 6547

Urdhër i MD nr.5123/3, datë 24.8.2011	Për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit	6548
Urdhër i MD nr.5123/3, datë 24.8.2011	Për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit	6548
Urdhër i MD nr.5123/3, datë 24.8.2011	Për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit	6549
Kërkesë e MF nr.1304/8, datë 3.10.2011	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi dhe rikonstruksioni i pikës së kalimit kufitar Morinë-Kukës.....	6550
Kërkesë e MPPT nr.3932/2, datë 4.10.2011	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Lezhë-Shëngjin” (truall dhe arë).....	6551
Kërkesë e MPPT nr.884/3, datë 12.10.2011	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan-Tepelenë”.....	6552

LIGJ
Nr.10 466, datë 6.10.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8386, DATË 30.7.1998 “PËR MËNYRËN DHE
PROCEDURAT E SHITJES SË PRONAVE TË PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË QË
KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në fund të pikës 9.1 të nenit 9 të ligjit nr.8386, datë 30.7.1998 “Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pronave të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, hiqen fjalët “vetëm kur hapet ankandi”.

Neni 2

Çdo ligj apo akt nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7129, datë 25.10.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 468, datë 6.10.2011

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË SHTETIT PËR VITIN 2010

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 63 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratimi i buxhetit faktik

Miratohet Buxheti faktik i Shtetit për vitin 2010, së bashku me burimet e tij të financimit, si më poshtë:

Në milionë lekë

1. Buxheti i Shtetit	
Të ardhurat, gjithsej	273 090
Shpenzimet, gjithsej	300 467
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore	
Të ardhurat	80 134
Shpenzimet	79 316
3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore	
Të ardhurat	13 669
Shpenzimet	25 141
4. Deficiti buxhetor	(38 031)
5. Financimi i deficitit buxhetor	38 031
I brendshëm	27 819
A. Me instrumente financiare	
(kredimarrje e brendshme, neto)	25 948
1. Kredimarrje nga pushteti qendror	25 801
a) Bono thesari	(9 350)
b) Euro bono	3 264
c) Obligacione qeveritare 2/3/5/7-vjeçare	17 223
ç) Eurobond	14 664
2. Kredimarrje nga pushteti vendor	147
B. Të ardhura nga privatizimi	411
C. Të tjera	1 460
Ndryshimi i gjendjes së arkës	(255)
Të tjera	1 715
Financimi i jashtëm (neto)	10 212
Nga i cili:	
Mbështetje buxhetore	0.

Neni 2 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7131, datë 25.10.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.664, datë 28.9.2011

**PËR MOTIVIMIN, RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E MEDALJEVE,
FORMËN E TYRE DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 125 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Medaljet jepen nga Ministri i Brendshëm, për punonjësit e Policisë, punonjësit e shërbimeve mbështetëse dhe punonjës policie të huaj, të atashuar në vendin tonë, kur ata shquhen për merita të veçanta.

2. Medaljet që jepen janë:

- Medalja e Nderit;
- Medalja për Trimëri;
- Medalja për Shpëtim Jete.

3. Motivacionet për dhënien e medaljeve

a) Medalja e nderit

U jepet punonjësve të Policisë, punonjësve të shërbimeve mbështetëse dhe punonjësve policie të huaj të atashuar në vendin tonë, të cilët shquhen për merita dhe shërbime të veçanta në luftën ndaj krimit, sigurimit të rendit e të qetësisë publike, ruajtjen e administrimit e pronës dhe në ushtrimin e përgjegjësisë të tjera të parashikuara me ligj për Policinë e Shtetit, si dhe në mbështetjen e Policisë së Shtetit.

b) Medalja për Trimëri

U jepet punonjësve të Policisë, të cilët tregojnë cilësi të veçanta, kurajë e guxim në realizimin e detyrave, misionëve dhe situatave të jashtëzakonshme.

c) Medalja për Shpëtim Jete

U jepet punonjësve të Policisë, të cilët tregojnë akte ose veprime heroike në një konflikt, operacion a situatë të jashtëzakonshme për shpëtimin e jetës së qytetarëve, kolegëve, duke vënë në rrezik jetën e tyre.

4. Për dhënien e medaljeve zbatohen rregullat dhe procedurat e mëposhtme:

a) Ministri i Brendshëm ka të drejtë për dhënien e medaljeve me nismën e institucioneve vartëse, me ose pa propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

b) Propozimi ose nisma për dhënien e medaljes shoqërohet gjithmonë me përshkrimin e arritjeve dhe veprimtarinë konkrete ku është dalluar i propozuari.

c) Dhënia e medaljeve bëhet në raste festash kombëtare, përvjetorësh, datash historike dhe ngjarjesh të shënuara për Policinë e Shtetit.

ç) Dhënia e medaljeve, në çdo rast, organizohet me ceremoni. Ceremonia e dhënies së medaljes organizohet nga institucioni që ka inicuar dhënien e saj.

d) Dorëzimi i medaljes bëhet në prani të punonjësve të policisë së strukturës iniciuese, pjesëtarëve të familjes dhe të të ftuarve të tjerë. Medalja i dorëzohet vetë personit. Nëse dhënia e medaljes është pas vdekjes, ajo i jepet pjesëtarëve të familjes së tij.

dh) Dhënia e medaljes bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi i saj, përveç rasteve kur shtyhet për arsye objektive.

5. Medalja shoqërohet me certifikatë. Format i certifikatës është letër A4 (8.27x11.69), cilësi e parë, me fushë stemën e institucionit që jep medaljen, me kornizë dhe me shirit anash.

6. Certifikata duhet të përmbajë lart, në qendër, stemën e Republikës së Shqipërisë, institucionin, autoritetin që jep medaljen, gradën, emrin, mbiemrin e personit që i jepet medalja, titullin e medaljes, motivacionin, numrin dhe datën e urdhrin për dhënien e medaljes, në fund emri, mbiemri dhe firma e ministrit që jep medaljen dhe vula.

7. Forma e medaljeve është sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Dhënia e medaljes shoqërohet me një shpërblim financiar, i cili është:

a) Për punonjësit e policisë me gradë policore;

i) Për Medaljen e Nderit, në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ii) Për Medaljen e Trimërisë, në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë;

iii) Për Medaljen për Shpëtim Jete, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Shpërblimi për dhënien e medaljes së këtyre punonjësve përballohet nga buxheti i miratuar për strukturën iniciuese.

b) Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse, shpërblimi financiar, për secilën prej medaljeve, është në masën e një page referuese mujore, ndërsa për punonjës policie të huaj të atashuar në vendin tonë, për secilën medalje, shpërblimi financiar është në masën e një page referuese të gradës “Drejtues”.

Shpërblimi në këto raste, bëhet në përputhje me vendimin nr.183, datë 9.2.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”.

9. Numri i punonjësve të Policisë që mund të marrin “Medaljen e Nderit” dhe “Medaljen e Trimërisë”, të jetë jo më shumë se 10 (dhjetë) veta, për çdo vit.

10. Medaljet mbahen në uniformën e punonjësit të Policisë dhe uniformën ceremoniale.

11. Ngarkohen Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet e tij financiare fillojnë nga data 1 janar 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.673, datë 6.10.2011

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE, PËR RIPARIMIN E MBULESËS SË SALLËS SË MADHE TË KONCERTEVE, NË PALLATIN E KONGRESEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, t’i shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, për riparimin e mbulesës së sallës së madhe të koncerteve, në Pallatin e Kongreseve.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.713, datë 20.10.2011

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifatat”, të ndryshuar, dhe të neneve 54 e 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Vendimi nr.549, datë 26.8.1996 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, shfuqizohet.
 3. Ngarkohet kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSME**

Nr.	LLOJI I SHËRBIMEVE	Tarifa e re në lekë
1	Lëshim i certifikatave të pasurisë	1,500
2	Kërkese për regjistrim të pronësive të pasurisë së paluajtshme	700
3	Kërkese për regjistrimin e pjesëtimit të ndarjes së bashkimit të pasurisë të paluajtshme	700
4	Kërkese për konsultim të karteles dhe të dhëna vete tjera të pasurisë së paluajtshme	700
5	Kërkese për informacion zyrtar të regjistrimit të pasurisë të paluajtshme për individët dhe institucionet	800
6	Kërkese për lëshim të kopjes së certifikatës së pasurisë të paluajtshme	800
7	Kërkese për saktësimin e kufijve	2,500
8	Kërkese për përgatitjen e dokumentave në gjykatë ose organ tjetër administrativ	900
9	Kërkesë për regjistrim për kalim pronësie, qiraje nënqiraje të pasurisë së paluajtshme	3,500
10	Kërkesë për regjistrim hipoteke, hipoteke ligjore	1,000
11	Kërkesë për regjistrim për fshirje hipoteke, hipoteke ligjore	1,000
12	Kërkesë për regjistrim për fshirjen e një vendimi gjykatë, të një akti administrativ	1,000
13	Kërkesë për regjistrim servituti, marreveshje kufizuese	900
14	Kërkesë për regjistrim për fshirjen e një servituti, marreveshje kufizuese	900
15	Regjistrimi i kërkesave për heqjen dorë nga të drejtat pasurore mbi pasurinë e paluajtshme	800
16	Regjistrimi i kërkesave për fitimin e pronësive mbi pasurinë e paluajtshme me trashëgimi	700
17	Kërkesë për korigjimin e gabimeve materiale në kartele	700
18	Kërkesë për lëshim kopje kartele harte treguese ose pjesë të saj	1,000
19	Kërkesë për fotokopje të dokumentave të pasurisë të paluajtshme për çdo faqe	200
20	Lëshim vërtetimi pronësie (negative)	300
21	Lëshim vërtetimi pronësie	1,500
22 a)	Regjistrimi fillestar i pasurisë të paluajtshme në zonat urbane pa rilevim e azhurnim të pasurisë nga zyrtarët e regjistrimit të pasurisë	5,000
22 b)	Regjistrimi fillestar i pasurisë të paluajtshme në zonat urbane me rilevim e azhurnim të pasurisë nga zyrtarët e regjistrimit të pasurisë	8,000
23 a)	Shërbime për veprimet e Bankave e institucioneve tjera kredidhenese për kredi me vlerë deri 1,000,000 lekë	7,500
23 b)	Shërbime për veprimet e Bankave e institucioneve tjera kredidhenese për kredi me vlerë 1,000,001 deri në 10,000,000 lekë	15,000
23 c)	Shërbime për veprimet e Bankave e institucioneve tjera kredidhenese për kredi me vlerë mbi 10,000,000 lekë	25,000
24	Regjistrimi fillestar i vecantë të pasurisë të paluajtshme në zonat rurale	30,000
25	Regjistrim provizor i karabinase	6,500

URDHËR
Nr.2004, datë 15.3.2011

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 6, germa “b” të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit z.Partizan Laze Hyseni, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, i datëlindjes 31.12.1945.
 2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit, të përbërë nga 5 anëtarë:
 - a) Z.Arlin Arapi, përgjegjës i sektorit të inspektimit për zbatimin e drejtësisë.
 - b) Zj.Aleksandra Tasi, specialiste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
 - c) Znj. Mirela Llaperi, arkiv-protokoll në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
 - d) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.
 - e) Një përfaqësues i dhomës Kombëtare të Noterisë.
 3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal, në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Tiranë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.
 4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit z.Partizan Hyseni nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.
 5. Urdhri t'i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve të varësisë të Ministrisë së Drejtësisë.
 6. Ngarkohet sektori i inspektimit për zbatimin e drejtësisë dhe zyra e mbajtjes së regjistrit të noterëve, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani

URDHËR
Nr.5123/3, datë 24.8.2011

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, nenit 6, germa “b” të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit znj.Afërdita Tele Haxhia, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, pasi ka mbushur moshën 65 vjeç.
2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit, të përbërë nga 5 anëtarë:
 - a) Z.Arlind Arapi, përgjegjës i sektorit të inspektimit për zbatimin e drejtësisë.

- b) Znj.Aleksandra Tasi, specialiste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
- c) Znj.Mirela Llaperi, arkiviste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
- d) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.
- e) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal, në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Tiranë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres znj.Afërdita Tele Haxhia, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

5. Urdhri t'i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Ngarkohet sektori i inspektimit për zbatimin e drejtësisë dhe zyra e mbajtjes së regjistrit të noterëve të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR **Nr.5123/3, datë 24.8.2011**

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, nenit 6, germa "b" të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit z.Xhevdet Bajram Hamzaj, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, pasi ka mbushur moshën 65 vjeç.

2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit të përbërë nga 5 anëtarë:

- a) Z.Arlind Arapi, përgjegjës i sektorit të inspektimit për zbatimin e drejtësisë.
- b) Znj.Aleksandra Tasi, specialiste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
- c) Znj. Mirela Llaperi, arkiviste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
- d) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.
- e) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal, në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Tiranë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit z.Xhevdet Barjam Hamzaj, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

5. Urdhri t'i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Ngarkohet sektori i inspektimit për zbatimin e drejtësisë dhe zyra e mbajtjes së regjistrit të noterëve të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR
Nr.5123/3, datë 24.8.2011

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, nenit 6 germa “b” e ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit z.Selim Myftar Beqiraj, anëtar i Dhomës së Noterisë Durrës, pasi ka mbushur moshën 65 vjeç.
2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit, të përbërë nga 5 anëtarë:
 - a) Z.Arlind Arapi, përgjegjës i sektorit të inspektimit për zbatimin e drejtësisë.
 - b) Znj.Aleksandra Tasi, specialiste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
 - c) Znj. Mirela Llaperi, arkiviste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
 - d) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Durrës.
 - e) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.
3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal, në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Durrës. Arkivi do t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Durrës që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.
4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit z. Selim Myftar Beqiraj, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.
5. Urdhri t’i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.
6. Ngarkohet sektori i inspektimit për zbatimin e drejtësisë dhe zyra e mbajtjes së regjistrit të noterëve të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR
Nr.5123/3, datë 24.8.2011

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, nenit 6, germa “b” të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit z.Vangjel Andon Daka, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, pasi ka mbushur moshën 65 vjeç.
 2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit, të përbërë nga 5 anëtarë:
 - a) Z.Arlind Arapi, përgjegjës i sektorit të inspektimit për zbatimin e drejtësisë.
 - b) Znj.Aleksandra Tasi, specialiste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
 - c) Znj.Mirela Llaperi, arkiviste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
 - d) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.
 - e) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.
 3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal, në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Tiranë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.
 4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit z. Vangjel Andon Daka, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.
 5. Urdhri t’i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.
 6. Ngarkohet sektori i inspektimit për zbatimin e drejtësisë dhe zyra e mbajtjes së regjistrit të noterëve të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR
Nr.5123/3, datë 24.8.2011

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, nenit 6 germa “b” të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit z.Halil Ukë Sinani, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, pasi ka mbushur moshën 65 vjeç.
2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit të përbërë nga 5 anëtarë:
 - a) Z.Arlind Arapi, përgjegjës i sektorit të inspektimit për zbatimin e drejtësisë.
 - b) Znj.Aleksandra Tasi, specialiste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
 - c) Znj.Mirela Llaperi, arkiviste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.

- d) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.
- e) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal, në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Tiranë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit z. Halil Ukë Sinani, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

5. Urdhri t'i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Ngarkohet sektori i inspektimit për zbatimin e drejtësisë dhe zyra e mbajtjes së regjistrit të noterëve të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR
Nr.5123/3, datë 24.8.2011

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, nenit 6 germa "b" të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit znj. Fatime Bajram Metaj, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, pasi ka mbushur moshën 65 vjeç.

2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit, të përbërë nga 5 anëtarë:

- a) Z. Arlind Arapi, përgjegjës i sektorit të inspektimit për zbatimin e drejtësisë.
- b) Znj. Aleksandra Tasi, specialiste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
- c) Znj. Mirela Llaperi, arkiviste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
- d) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.
- e) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal, në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Tiranë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres znj. Fatime Bajram Metaj, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

5. Urdhri t'i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Ngarkohet sektori i inspektimit për zbatimin e drejtësisë dhe zyra e mbajtjes së regjistrit të noterëve të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

KËRKESË
Nr.1304/8, datë 3.10.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Financave shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi dhe rikonstrukcioni i pikës së kalimit kufitar Morinë-Kukës.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” (sipërfaqet m²), si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 (objekti) për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Financave).

Për pasuritë me pronarë të pakonfirmuar, për të cilët bëhet shënimi në kolonën përkatëse “I pakonfirmuar”, sqarojmë se këta persona që pretendojnë pronësinë, duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP-së, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 8 060 014.36 (tetë milionë e gjashtëdhjetë mijë e katërmëdhjetë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode

LISTA PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I ZGJERIMIT DHE
RIKONSTRUKSIONIT TË PIKËS KUFITARE MORINË - KUKËS

Lloji i pasurisë: tokë arë
Fshati Morinë, Z. K.2724

Pronari			ZK	Nr. i pasurisë	Tokë arë			Shënime
Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m ²	Çmimi	Vlera lekë	
Rive	Iljaz	Duraku	2724	83/8	4839	167	808113	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Kujtim	Islam	Duraku	2724	82/8/9	2856	167	476952	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Kujtim	Islam	Duraku			299	167	49933	I pakonfirmuar nga ZVRPP-ja
Gjemshit	Shaqir	Duraku	2724	83/12	416	167	69472	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI							1404470	

Lloji i pasurisë: truall
Fshati Morinë, Z. K.2724

Pronari						Tokë arë	(bashkëpron)	
Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. pas	Sip m ²	Çmimi lekë/ m ²	Vlera	Shënime
Rive	Iljaz	Duraku	2724	83/5	416.7	1071	446285	Konfirmuar nga ZVRPP-
Kujtim	Islam	Duraku	2724	83/5	416.6	1071	446285	Konfirmuar nga ZVRPP-
Ylber	Islam	Duraku	2724	83/5	416.7	1071	446285	Konfirmuar nga ZVRPP-
	TOTALI						1338855	

Lloji i pasurisë: godina
Fshati Morinë, Z. K.2724
Lloji i pasurisë: objekt

Pronari						Objekt(bashkëpron)		
Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. (m ²)	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Shenime
Rive	Iljaz	Duraku	2724	83/5	83.8166	21168	1774229.7888	Konfirmuar nga ZVRPP
Kujtim	Islam	Duraku	2724	83/5	83.8166	21168	1774229.7888	Konfirmuar nga ZVRPP
Ylber	Islam	Duraku	2724	83/5	83.8166	21168	1774229.7888	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI						5322689.3664	

KËRKESË Nr.3932/2, datë 4.10.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Lezhë-Shëngjin” (truall dhe arë).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 586 360 (katër milionë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
“LEZHË-SHËNGJIN”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastr.	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²	Çmimi për njësi	Vlera (lekë)	Shënime
1	Bashkëpronarët Cetaj+Martini			3126	5//41	truall	176	25510	4489760	Konfirmim nga ZVRPP-ja
2	Prek	Gjeto	Gjeloshi	1987	12/14//1	arë	230	420	96600	Konfirmim nga ZVRPP-ja
		Shuma					406		458 6360	

Mbyllet me numër rendor 2.

KËRKESË
Nr.884/3, datë 12.10.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan-Tepelenë”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit: kultura bujqësore dhe dru frutorë.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë provave për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 504 230 (katër milionë e pesëqind e katër mijë e dyqind e tridhjetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldash

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR

"LEVAN-TEPELEN " PER KULTURAT BUJQESORE DHE DRUFRUTORE

Nr	Emeri	Atesia	Mbiemri	Z.K	Nr. Pas	Sip Shpro m2	Kul.Bujq Vlera Lek	Dru Frutore Vlera Lek	Total Lek	Shenime
FSHATI GJONC, KOMUNA CAKRAN										
1	Ismail	Qemal	Avdia	1758	9/1	307	1228		1228	Konf ZRPP
2	Qerim	Qemal	Avdia	1758	9/2	347	1388		1388	Konf ZRPP
3	Astrit	Muço	Saliaj	1758	9/3	465	1860		1860	Konf ZRPP
4	Ferrik	Feçorr	Myftari	1758	9/5	268	1072		1072	Konf ZRPP
5	Kujtim	Feçorr	Myftari	1758	9/6	221	668		668	Konf ZRPP
6	Lefter	Feçorr	Myftari	1758	9/7	167	884		884	Konf ZRPP
FSHATI VARIBOB, KOMUNA CAKRAN										
7	Zahir	Ali	Alibeaj	3816	299/11	903	10800		10800	Konf ZRPP
8	Xhemal		Velaj	3816	42/7	4935	24675		24675	Konf ZRPP
FSHATI BUZE E MADHE, KOMUNA CAKRAN										
9	Ylmi	Hekuran	Bendaj	1341	223	331	3475		3475	Konf ZRPP
FSHATI LEVAN, KOMUNA LEVAN										
10	Rahman		Caushaj	2436	249/32	460	6650		6650	Konf ZRPP
11	Fadil	Hysen	Mema	2436	249/2	952		348000	348000	Konf ZRPP
12	Mentor		Mema	2436	249/3	877	10500		10500	Konf ZRPP
13	Taro	Haki	Caushaj	2436	249/5	817		232845	232845	Konf ZRPP
14	Gjylmore	Sadik	Caushaj	2436	249/6	1029	14700		14700	Konf ZRPP
15	Agron	Haki	Caushaj	2436	249/7	817	11550		11550	Konf ZRPP
16	Haredin	Muhamet	Lamaj	2436	249/8	1101	13200		13200	Konf ZRPP
17	Ilmi	Sadik	Cobo	2436	140/1	2173	26100		26100	Konf ZRPP
18	Laver	Qemal	Cobo	2436	139/1	1421	32100		32100	Konf ZRPP
19	Fuat	Qemal	Cobo	2436	139/2	1950	43950		43950	Konf ZRPP
20	Nexhmedin	Osmen	Fejzullai	2436	138/1	1757	10983		10983	Konf ZRPP
21	Beqar	Sulo	Mehmetaj	2436	138/2	1068	6675		6675	Konf ZRPP
22	Refat	Jonuz	Braka	2436	121/36	195	2340		2340	Konf ZRPP
23	Nazmi		Cobo	2436	143/1	1211	145320		145320	Konf ZRPP
24	Tajar		Cobo	2436	142/1	925	11100		11100	Konf ZRPP
25	Aleks		Dulaj	2436	143/3	416	49920		49920	Konf ZRPP
26	Meti		Dulaj	2436	143/4	923	110760		110760	Konf ZRPP
27	Sedar		Dulaj	2436	143/5	697	83640		83640	Konf ZRPP
28	Arben		Dulaj	2436	143/6	25	3000		3000	Konf ZRPP
29	Bajram		Cobo	2436	140/2	2250	47250		47250	Konf ZRPP
30	Ali		Lanaj	2436	249/29	1518	182160		182160	Konf ZRPP
31	Fatos		Lanaj	2436	256/1	852	102240		102240	Konf ZRPP
32	Lutfi		Lanaj	2436	256/2	1056	126720		126720	Konf ZRPP
33	Ajet		Buxaj	2436	256/3	429	6020		6020	Konf ZRPP
34	Asqeri		Cobo	2436	142/2	401	4812		4812	Konf ZRPP
35	Petrit		Zeqaj	2436	256/5	905	10860		10860	Konf ZRPP
36	Ramiz		Shahaj	2436	249/16	707	4420		4420	Konf ZRPP
37	Elmaz		Shahaj	2436	249/17	735	10290		10290	Konf ZRPP

38	Avdyl		Shahaj	2436	249/19	660	9220		9220	Konf ZRPP
39	Nazmi		Hajdari	2436	249/26	825	11550		11550	Konf ZRPP
40	Hasan		Hajdari	2436	249/25	794	11130		11130	Konf ZRPP
41	Lavdosh		Shahaj	2436	249/20	535	16050		16050	Konf ZRPP
42	Hamit		Hallidri	2436	249/21	420	2625		2625	Konf ZRPP
	FSHATI FRAKULL E MADHE, KOMUNA FRAKULL									
43	Balil	Bege	Bega	1634	3/25	3378		1852500	1852500	Konf ZRPP
44	Artur		Naci	1634	75/6	870		772800	772800	Konf ZRPP
	FSHATI KLOSE, KOMUNA HEKAL									
45	Nexhip		Ismaili	2160	355/5	30		50000	50000	Konf ZRPP
46	Dilaver		Çalaj	2160	396	1285	21000		21000	Konf ZRPP
	FSHATI VASJAR, KOMUNA F.MEMALIAJ									
47	Perparim		Zaçe	3719	295/12	189		27800	27800	Konf ZRPP
48	Bedri		Zaçe	3719	518/3	3891		9600	9600	Konf ZRPP
49	Nezir		Zaçe	3719	297/45	697		15800	15800	Konf ZRPP
						Shuma	1194885	3309345	4504230	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 28.10.2011
Doli nga shtypi më 31.10.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja Mediaprint
Tiranë, 2011

Çmimi 20 lekë